

VENDIM
Nr. 42, datë 29.4.2013

**MBI TRANSFERIMIN E AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË
“HEC BISTRICA 1 DHE BISTRICA 2” SHA, NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGJETIKËS TE “KURUM INTERNATIONAL” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ligjit nr. 93/2013, datë 4.3.2013 “Për ratifikimin e kontratës për shitjen e 100 % të aksioneve të shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a., të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Kurum International””, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 9.1.2013 “Për miratimin e raportit përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe të kandidatit fitues për privatizimin e shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a.”, pikës 6.2 të licencës së prodhimit të energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe aplikimit të shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2”, për transferimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. nga METE te “Kurum International” sh.a. dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e aksionarit që kontrollon interesin e shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës te “Kurum International” sh.a.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani